




Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo



Komuna e Istogut

Opština Istok

Municipality of Istog

**LIBRI I PROCESIVE PËR
MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE
PUBLIKE**

SHTATOR, 2020

TABELA E PËRMBAJTJES









SHKURTESAT	4
LEGJENDA	5
HYRJE	6
I. Procesi i Buxhetit Komunal	9
1. Procesi i Buxhetit Komunal: Të dhënat e Përgjithshme	10
2. Procesi i Buxhetit Komunal: Procesi në Detaj	11
3. Procesi i Buxhetit Komunal: Lista e Rreziqeve	24
4. Procesi i Buxhetit Komunal: Diagrami i Procesit	27
II. Procesi i Menaxhimit të Pagave	32
1. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Të Dhënat e Përgjithshme	33
2. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Procesi në Detaj	34
3. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Lista e Rreziqeve	45
4. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Diagrami i Procesit	48
III. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta	52
1. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Të Dhënat e Përgjithshme	53
2. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Procesi në Detaj	54
3. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Lista e Rreziqeve	63
4. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Diagrami i Procesit	66
IV. Procesi i shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime	69
1. Procesi i Shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime: Të dhënat e Përgjithshme	70
2. Procesi i Shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime: Procesi Në Detaj	73
3. Procesi i Shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime: Lista e Rreziqeve	92
4. Procesi i Shpenzimeve: Mallra dhe Shërbime: Diagrami i Procesit	96
V. Procesi i Shpenzimeve - Avance dhe Paraja e Imët	101
1. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Të Dhënat e Përgjithshme	102
2. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Procesi në Detaj	103
3. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Lista e Rreziqeve	110
4. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Diagrami i Procesit	112
VI. Procesi i Shpenzimeve - Udhëtimet Zyrtare	114
1. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Të Dhënat e Përgjithshme	115
2. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Procesi në Detaj	116
3. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Lista e Rreziqeve	122
4. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Diagrami i Procesit	125
VII. Procesi i shpenzimeve - Komunalitë	127
1. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Të Dhënat e Përgjithshme	128
2. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Procesi Në Detaj	129
3. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Lista e Rreziqeve	137
4. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Diagrami i Procesit	139
VIII. Procesi i Shpenzimeve - Subvencione dhe Transfere	141
1. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Të Dhënat e Përgjithshme	142
2. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Procesi në Detaj	143
3. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Lista e Rreziqeve	156
4. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Diagrami i Procesit	160
IX. Procesi i shpenzimeve - Investimet Kapitale	163
1. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Të Dhënat e Përgjithshme	164
2. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Procesi në Detaj	166
3. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Lista e Rreziqeve	184
4. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Diagrami i Procesit	196
X. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale	201
1. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale: Të Dhënat e Përgjithshme	202
2. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale: Procesi në Detaj	205
3. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale: Lista e Rreziqeve	239
4. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale: Diagrami i Procesit	254

XI. Procesi i Menaxhimit të Projekteve	256
1. Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Të Dhënat e Përgjithshme	257
2. Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Procesi në Detaj	258
3. Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Lista e Rreziqeve	267
4. Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Diagrami i Procesit	272
XII. Procesi i Prokurimit	274
1. Procesi i Prokurimit: Të Dhënat e Përgjithshme	275
2. Procesi i Prokurimit: Procesi në Detaj	276
3. Procesi i Prokurimit: Lista e Rreziqeve	291
4. Procesi i Prokurimit: Diagram i Procesit	295
XIII. Procesi i Menaxhimit të Kontratave	299
1. Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Të Dhënat e Përgjithshme	300
2. Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Procesi në Detaj	301
3. Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Lista e Rreziqeve	310
4. Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Diagrami i Procesit	313

SHKURTESAT

AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
ATK	Administrata Tatimore i Kosovës
BDK	Bordi i Drejtorëve në Komunë
BNJ	Burimet Njerëzore
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DBF	Drejtori për Buxhet dhe Financa
DNPDPF	Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve
DPTTh	Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit
FDHLP	Formulari I të Dhënave të Listës së Pagave
KAB	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KK	Kuvendi Komunal
KMC	Komision për Monitorimin e Cilësisë
KPF	Komiteti për Politike dhe Financa
KPK	Komiteti për Komunitete
KPM	Komisioni i Pranimit të Materialit
KPPTP	Komisioni për Pranim të Përkohshëm Teknik të Punimeve
LLVTh	Llogaria e Vetme e Thesarit
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MEK	Menaxheri i Ekzekutimit të Kontratës
MEP	Menaxheri i Ekzekutimit të Projektit
MEU	Mbikëqyrësi i Ekzekutimit të Urdhërësës
MF	Ministria e Financave
NJQH	Njësia Qendrore Harmonizuese e Kosovës
OE	Operatori Ekonomik
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PIP	Projekti i Investimeve Publike
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QSHQ	Qendra për Shërbime me Qytetarë
SIMBNJ	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë
SIP	Sistemi Informativ i Pagave
SMVP	Sistemi Informativ i Vijueshmërisë në Punë
SZHMB	Sistemi për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Buxhetit
UOP	Urdhër Obligimin për Pagesë
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
ZP	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

LEGJENDA



HYRJE

Ky dokument përbën një përmbledhje të proceseve kryesore të cilat kanë implikime në hallkat e kontrollit dhe ekzekutimit financiar në komuna në Kosovë. Proceset e poshtëshënuara mbështeten në Ligjet e Republikës së Kosovës, Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe procedurat e institucioneve qendrore dhe lokale. Libri i Proceseve synon të sqarojë dhe konsolidojë procedurat që duhet ndjekur për të siguruar kontroll të rregullsisë dhe cilësisë në procesin e buxhetimi dhe ekzekutimit të tij.

Qëllimi

Libri i Proceseve përbën një përmbledhje të proceseve të cilat qoftë në tërësi apo pjesërisht ndikojnë në performancën, mbikëqyrjen dhe rregullsinë financiare të Komunave. Ky libër vjen si rezultat i iniciativës të Njësisë Qendrore Harmonizuese të Ministrisë së Financave për të inkurajuar draftimin e proceseve në secilën organizatë buxhetore me qëllim të thjeshtimit të punës.

Përdorimi

Libri i Proceseve është një dokument i "gjallë" i cili duhet të rishikohet së paku në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet e mundshme në kornizën ligjore apo rregullative dhe përmirësimet në praktikën e mira kombëtare dhe ndërkombëtare në proceset e përfshira në këtë libër. Ndryshimet në Libër të Proceseve duhet të bëhen rregullisht, dhe këto ndryshime si dhe versioni i përditësuar i dokumentit duhet t'u komunikohet të gjithë palëve të interesit.

Ky dokument gjithashtu ndihmon në caktimin e qartë të vijave të përgjegjësive të të gjithë palëve të përfshira në proces si dhe hallkave që duhen ndjekur për të siguruar integritetin e funksioneve të institucioneve përkatëse. Nga ana tjetër, një përmbledhje e detajuar e proceseve gjithashtu ndihmon në përgatitjen e stafit ekzistues dhe atij të ri në mbarëvajtjen e detyrave të pozitave të tyre.


Struktura e librit

Ky dokument e shfleton secilin proces në tre mënyra. Për secilin proces, përdoruesit mund të gjejnë një përshkrim të përgjithshëm me informatat kryesore rreth pronarit të procesit (apo personit kryesor përgjegjës), ligjeve dhe rregulloreve që ndikojnë procesin, dokumenteve që duhen prodhuar, mjeteve informative të përfshira si dhe detaje të tjera. Pas përshkrimit, secili proces gjithashtu përmban hallkat e detajuara të procesit të cilat shpjegojnë veprimet, informatat, dokumentet, afatet dhe personat përgjegjës për secilën hallkë. Në fund, secili proces ka diagramin e vet i cili synon të lehtësojë kuptimin e procesit në tërësi si dhe ndjekjen e lehtë të procesit gjatë implementimit dhe mbikëqyrjes.

Në fund, ky libër përmban hallka të proceseve të cilat në mungesë të rregullativës specifike ligjore i janë përmbajtur praktikave të mira në mbarëvajtjen e proceseve. Këto hallka janë

zhvilluar si rezultat i eksperiencës dhe praktikave të implementuara në komunë që ka
zhvilluar këtë Libër të Proceseve.

Diagrami i Përgjithshëm i Integruar i Procesit të Planifikimit dhe Shpenzimit




I. PROCESI I BUXHETIT KOMUNAL

1. PROCESI I BUXHETIT KOMUNAL: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Titulli i procesit:	Procesi i Buxhetit Komunal
Organizata Buxhetore:	Komuna
Data e rishikimit:	<TBD>
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	<p>Procesi ka për qëllim përshkrimin e procedurave të përgatitjes së buxhetit komunal si dhe ndërlidhjes së procedurave komunale të përgatitjes së buxhetit me përgatitjen e buxhetit kombëtar.</p> <p>Procesi evidenton hallkat vendimmarrëse brenda Komunës sa i përket proceseve të planifikimit, draftimit, dëgjimeve publike dhe rishikimit pas qarkoreve qendrore buxhetore të buxhetit. Procesi gjithashtu evidenton proceset e komunikimit dhe bashkërendimit me Ministrinë e Financave për buxhetin e përgjithshëm kombëtar.</p>
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Njësia Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave
Versioni:	V. 01/2018
Korniza ligjore:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.
Pronari i Procesit:	1. Kryetari i Komunës
Palët e përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Financave 2. Analisti/ja për Buxhet Komunal në Ministrinë e Financave 3. Kryetari i Komunës 4. Drejtori për Buxhet dhe Financa / Zyrtari Kryesor Financiar Komunal 5. Drejtorët e Drejtorive Komunale 6. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) 7. Kuvendi Komunal dhe Kryesuesi
Sistemet e TI të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB) 2. E-Mail 3. Ueb faqet e Ministrisë së Financave dhe Komunës 4. Programi i Investimeve Publike (PIP)
Dokumentet e përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Qarkorja e Parë Buxhetore 2. Qarkorja e Dytë Buxhetore 3. Qarkorja e Brendshme Komunale 4. Korniza Afatmesme e Buxhetit (KAB) 5. Projekt Buxheti 6. Lista e propozimeve dhe ideve nga dëgjimet publike 7. Vendimi i Kuvendit Komunal për aprovimin e Draft Buxhetit 8. Shkresa përcjellëse e Kryetarit të Komunës për dërgimin e buxhetit të aprovuar të Ministrisë e Financave 9. Tabelat e buxhetit (4.1, 4.2 dhe 4.3) 10. Formularët e Shpenzimi të Departamenteve (PCF 1, PCF2, PCF3, dhe PCF4)
Ndërlidhja:	Nuk ka
Numri i hapave:	26

2. PROCESI I BUXHETIT KOMUNAL: PROCESI NË DETAJ


Procesi i përgatitjes së buxhetit komunal						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet	Korniza ligjore
1.	Pranimi i qarkores së parë nga Ministria e Financave	<p>1.1 Qarkorja e Ministrisë së Financave pranohet nga zyra e Kryetarit të Komunës përmes postës elektronike (e-maili), Drejtori për Buxhet dhe Financa (DBF)/Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF). Qarkorja gjithashtu publikohet në ueb faqen zyrtare të MF.</p> <p>1.2 DBF/ZKF përcjell qarkoren tek drejtorët e të gjitha drejtorive, udhëheqësitë programeve dhe të të gjithë palët me interes përmes e-mailit dhe/ose në kopje fizike.</p>	<p>1. Zyra e Kryetarit</p> <p>2. DBF/ZKF</p>	Deri me 15 Maj	1. Qarkorja në format Word	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
2	Hartimi i qarkores së brendshme komunale	<p>2.1 Kryetari i Komunës e dërgon qarkoren tek Drejtori për Buxhet dhe Financa (DBF) / Zyrtari Kryesor</p> 	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. Drejtorët e Drejtorisë Përkatëse</p>	15-22 Maj	1. Qarkorja e Brendshme Komunale në format Word	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit</p>

		<p>Financiar (ZKF).</p> <p>2.2 DBF/ZKF siguron se zhvillimin e qarkores së brendshme të komunës (në nivel të programeve dhe kategorive ekonomike).</p> <p>2.2.1 Qarkoren e brendshme e përgatitë (vendosja e të dhënave në tabela të buxhetit) DBF/ZKF. Kjo bëhet bazuar në informatat financiare nga vitet para-prake.</p>				<p>Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
3	<p>Shpërndarja/dorë zimi i qarkores së brendshme komunale</p>	<p>3.1 DBF/ZKF e shpërndan qarkoren e brendshme buxhetore tek drejtorët e të gjitha drejtorive dhe udhëheqësit e programeve.</p> <p>3.2 Drejtorët e drejtorive e shpërndajnë qarkoren e brendshme te:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëheqësit e njëjësive në kuadër të drejtorive të tyre; • Drejtorët e shkollave dhe çerdheve; dhe • Udhëheqësit e institucioneve shëndetësore. 	<p>1. DBF/ZKF</p> <p>2. Drejtorët e Drejtorive Komunale dhe udhëheqësit e njëjësive/program eve</p>	22 Maj	1. Qarkorja e Brendshme Komunale	NA
4	<p>Paraqitja e kërkesave buxhetore nga drejtoritë dhe programet tek DBF/ZFK për përgatitje të KAB</p>	<p>4.1 Pas pranimit të qarkores së brendshme, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e programeve fillojnë me përgatitjen e kërkesave buxhetore.</p> <p>4.2 Drejtorët e drejtorive diskutojnë kërkesat buxhetore me stafin e tyre.</p>	<p>1. Drejtorët e drejtorive dhe stafi i tyre</p> <p>2. Udhëheqësit e njëjësive</p> <p>3. DBF/ZKF</p>	5 Qershor	1. Formulari i nënshkruar nga drejtorët e drejtorive	NA

5	Dëgjimet e hershme buxhetore [OPSIONALE]	<p>4.3 Drejtorët e drejtorive dërgojnë propozimet buxhetore tek DBF/ZKF.</p> <p>5.1 Kryesuesi i Komitetit për Politike dhe Financa, në bashkëpunim me DBF/ZKF, drejtorët e drejtorive mbajnë dëgjime të hershme publike para hartimit të Kornizës Afatmesme Komunale të Buxhetit.</p>	1. Kryesuesi Kuvendit 2. DBF/ZKF	Fund i Majit	<p>1. Njoftimi për dëgjime buxhetore</p> <p>2. Përmbledhja e dëgjimeve të hershme buxhetore.</p>	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
6	Hartimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB)	<p>6.1 Bazuar në propozimet buxhetore të drejtorive dhe programeve si dhe inputet nga dëgjimet publike (brenda kufijve buxhetor), Kryetari i Komunës në bashkëpunim me DBF/ZKF, dhe drejtorët e drejtorive hartojnë draft Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB).</p>	1. Kryetari i Komunës 2. Drejtorët e drejtorive 3. DBF/ZKF	10 Qershor	1. Draft KAB	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

7	Prezantimi i draft KAB në Komitetin për Politikë dhe Financa	7.1 Kryetari i komunës e aprovon draft KAB-it. 7.2 Pas aprovimit, Kryetari së bashku me DBF/ZKF prezanton draft KAB në Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF).	1. Kryetari i Komunës 2. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) 3. Komiteti për Komunitete (KPK)	10-25 Qershor	1. Draft KAB	<u>Kosovës</u> . 1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
8	Inputet nga dy komitetet	8.1 Propozim ndryshimet eventuale të komiteteve plotësohen nga DBF/ZKF në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive përkatëse.	1. Kryetari i Komunës 2. DBF/ZKF 3. Drejtorët e drejtorive	25-30 Qershor	1. Draft KAB	<u>Kosovës</u> . 1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
9	KAB në Kuvend	9.1 Draft KAB dërgohet në Kuvend	1. Kryetari i	Deri më 30	1. Vendimi i	1. Ligji Nr.03/L-

10	Komunal	<p>Komunal për shqyrtim dhe aprovim.</p> <p>9.2 KAB aprovohet nga Kuvendi Komunal dhe vendimi për aprovim të KAB-it nënshkruhet nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal.</p>	<p>Komunës</p> <p>2. Kuvendi Komunal</p> <p>3. Kryesuesi i Kuvendit Komunal</p>	<p>Qershor</p> <p>30 Qershor</p>	<p>për aprovim KAB</p>	<p>048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
	Komunal	<p>10.1 Kryetari i Komunës e dërgon KAB (të aprovuar nga Kuvendi Komunal) në MF.</p>	<p>1. DBF/ZKF</p>	<p>30 Qershor</p>	<p>1. KAB-i aprovuar</p>	<p>048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

11	Pranimi i qarkores së dytë nga Ministria e Financave	<p>11.1 Dokumenti i Ministrisë së Financave pranohet në formë elektronike (e-mail) nga Kryetari i Komunës. Qarkorja gjithashtu publikohet në ueb site të MF.</p>  <p>Perdoren qarkorja e pare per cakton kufijtë buxhetar qarkorja e dyte specifikon se ku do te shpërndahet buxheti. Ministria e Financave mund te estojë me shumicë 1/3 qarkorja</p>	1. Kryetari i komunës	Nuk ka	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
12	Hartimi i qarkores së dytë të brendshme të Komunës dhe shpërndarja e saj tek drejtorët e drejtorive	<p>12.1 Hartohet qarkorja e dytë e brendshme e komunës nga DBF/ZKF (përfshihen inputet nga diskutimet e brendshme nga drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e programeve).</p> <p>12.2 DBF/ZKF dërgojnë qarkoren e dytë të brendshme tek drejtorët dhe udhëheqësit e njësive për plotësim. Qarkorja përcakton kufijtë buxhetor për kategori ekonomike.</p>	2. DBF/ZKF	Fund i Korrikut	<p>1. Qarkorja e Dytë Buxhetore</p> <p>1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
13	Dëgjimet publike	13.1 Mbahen dëgjime publike me qytetarë me qëllim të diskutimit të Projekt	1. Kryesuesi i Kuvendit	Muaji gusht	<p>1. Projekt Propozimi i</p> <p>1. Ligji Nr.03/L-048 për</p>

		Propozimit të Buxhetit.	2. DBF/ZKF	Buxhetit	Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
14	Përgatitja e projekt buxhetit dhe kërkesave për ndarje buxhetore në nivel të drejtorive	14.1 Pas pranimit dhe shpërndarjes së qarkores së dytë të brendshme, drejtorët e drejtorive organizojnë diskutime brenda drejtorive për të diskutuar kërkesat buxhetore. 14.2 Drejtorët e drejtorive i dërgojnë kërkesat buxhetore tek DBF/ZKF.	1. DBF/ZKF 2. Drejtorët e drejtorive	Propozimet buxhetore (PCF1,2,3 dhe 4)	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
15	Kontrollimi i propozimeve buxhetore dhe kërkesave për ndarje buxhetore	15.1 Kërkesat e drejtorive për ndarje buxhetore përkatëse diskutohen dhe dakordohen me Kryetarin e Komunës dhe DBF/ZKF.	1. Kryetari i Komunës 2. DBF/ZKF	NA	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

									<u>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</u> 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal <u>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</u>
16	sipas qarkores së dytë	Dorëzimi i projekt buxhetit dhe kërkesave për ndarje buxhetore në Kuvend Komunal	16.1 Projekt buxheti diskutohet nga Kryetari Komunës dhe Bordi i Drejtorëve dhe i dërgohet sekretarisë së Kuvendit Komunal për procedim të më tutjeshëm.	3. Shefi i planifikimit të buxhetit	1. Drejtorët e drejtorive 2. Kryesuesi i Kuvendit komunal	Para 1 Shtatorit	Projekt buxheti në kopje fizike	1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë <u>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</u> 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal <u>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</u>	
17	Futja e të dhënave preliminare buxhetore në SZHMB dhe në Programin e Investimeve Publike (PIP)	17.1 Të dhënat buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike futen në SZHMB dhe PIP nga zyrtarët e autorizuar. 17.2 Të gjitha këto të dhëna kontrollohen nga DBF/ZKF.	1. Zyrtarët e autorizuar 2. DBF/ZKF	Deri më 30 Shtator	1. Formularët e buxhetit të departamenteve nga SZHMB (PCF1,2,3 dhe 4) 2. Tablat e	1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë <u>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</u>			

18	Dëgjimet publike shtesë	18.1 Mbahen dëgjime publike me qytetarë me qëllim të diskutimit të Projekt Propozimit të Buxhetit me qytetarë.	1. DBF/ZKF 2. Kryesuesi i Kuvendit	1-12 Shtator	buxhetit (4.1, 4.2, 4.3)	2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
19	Shqyrtimi i kërkesave në KPF	19.1 Propozimet/idetë eventuale nga dëgjimet publike mund të dërgohen në KPF për shqyrtim.	1. KPF	1-12 Shtator	1. Propozimet/idetë nga dëgjimet publike	1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
20	Prezantimi në Kuvendin Komunal	20.1 Pas shqyrtimit të buxhetit në KPF, projekt buxheti prezantohet dhe diskutohet në Kuvendin Komunal.	1. Kryetari i Komunës	Deri 30 Shtator	1. Projekt buxheti	1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

21	Korrigjime në dokumentin e buxhetit duke u bazuar në inputet e dëgjimeve/komite teve/kuvendit	21.1 Nëse ka kërkesa për ndryshime (nga dëgjimet publike/komitetet/Kuvendi Komunal), projekt buxheti kthehet tek Kryetari i Komunës dhe DBF/ZKF për korrigjimet plotësuese dhe vendosjen e tyre në SZHMB dhe PIP.	1. Kryetari i Komunës	12-20 Shtator	1. Draft buxheti i korrigjuar	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).	Kosovës).
22	Aprovimi i buxhetit nga Kuvendi Komunal	22.1 Buxheti aprovohet nga Kuvendi Komunal.	1. Kuvendi Komunal	Deri me 30 Shtator	1. Buxheti i aprovuar 2. Vendim i Kuvendit Komunal	2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).	Kosovës).

23	Azhurnimi i buxhetit nëse ka pasur ndryshime gjatë aprovimit në Kuvend Komunal	23.1 Nëse buxheti i aprovuar në kuvend ndryshon nga projekt buxheti, ndryshimet vendosen në SZHMB dhe PIP nga zyrtarët e autorizuar.	1. Zyrtarët e autorizuar	Deri 30 Shtator	1. Buxheti i Aprovuar	049 për Financat e Pushtetit Lokal (<u>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</u>). 1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (<u>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</u>). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (<u>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</u>).
24	Njoftimi i analistëve në MIF dhe kontrolli final	24.1 Drejtori për Buxhet dhe Financa/ZKF gjatë gjithë kohës dhe sipas nevojë konsultohet me analistët e buxhetit në Ministri të Financave për asistencë gjatë hartimit të buxhetit. 24.2 Nëse ka nevojë analisti i MF-së jep udhëzimet e nevojshme për komunën.	1. DBF/ZKF 2. Analistët e buxhetit në MF	Deri 30 Shtator	NA	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (<u>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</u>). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (<u>Gazeta Zyrtare e</u>

25	Dorëzimi i Buxhetit në Ministrinë e Financave	25.1 Buxheti i komunës (i aprovuar në kuvend dhe nënshkruar prej kryesuesit të kuvendit) dërgohet në MF. 25.1.1 Bashkëngjitet shkresa përcjellëse nga Kryetari i Komunës për MF. 25.1.2 Dorëzohen tabelat buxhetore të zhvilluara nga SMZHB dhe PIP. • Tabela 4.1: Plani i ndarjes buxhetore të shpenzimeve. • Tabela 4.2: Financimi i projekteve kapitale. • Tabela 4.3: Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grandet qeveritare dhe të hyrat vetanake. • Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e buxhetit • Formulari i Buxhetimit i Përgjegjshëm Gjinor	1. Kryetari i Komunës	30 shtator	1. Dokumenti i buxhetit në kopje fizike dhe elektronike 2. Shkresa përcjellëse 3. Tabela 4.1 4. Tabela 4.2 5. Tabela 4.3 6. Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e buxhetit 7. Formulari i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor	Republikës së Kosovës). 1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
26	Kontrolli final dhe aprovimi i buxhetit nga analistët e MF	26.1 Analisti i buxhetit në MF bën kontrollin e fundit nëse buxheti është brenda kufijve të caktuar me qarkoren e dytë buxhetore në kategoritë ekonomike.	1. Analistët e buxhetit	30 Shtator		1. Ligji Nr.03/L-048 Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e

									Republikës së Kosovës).
									2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
Fundi i procesit të përgatitjes së buxhetit komunal									

26.2 Nëse ka ndonjë mospërputhje, buxheti kthehet mbrapa për korrigjim tek komuna


3. PROCESI I BUXHETIT KOMUNAL: LISTA E RREZIQEVE


REGJISTRI I RREZIQEVE PËR KOMUNËN E ISTOGËT							
Procesi i buxhetit komunal							
NR. RREZIKUT	PËRSHKRIMI I RREZIKUT	SHKAKU I RREZIKUT	PASOJAT	VLERËSIMI I RREZIKUT			VEPRIMET E NEVOJSHME PËR ZBUTJEN E RREZIKUT
				Mundësia	Ndikimi	Rezultati	
1.	Mbivlerësimi/nënvlerësimi i kërkesave buxhetore nga drejtoritë dhe programet buxhetore	Nevoja të reja dhe rrethana të ndryshuara Mos vlerësimi i sakët i kostove të kërkesave buxhetore Mungesa e kapaciteteve në përgatitjen e buxhetit	Dështimi për të siguruar mjete buxhetore për të plotësuar kërkesat e departamenteve Drejtoritë dështojnë të përmbushin objektivat e tyre Buxheti i pa shpenzuar Mos realizimi i kërkesave dhe nevojave Anulimi i procedurave të blerjeve dhe nevoja për përsëritje të tyre Dështimi për të ofruar shërbime ndaj qytetarëve	4	2	8	Mesëm Trajtimi i stafit për rritjen e kapaciteteve planifikuese Kujdes i shtuar gjatë procesit të planifikimit Vlerësimi i kostove të kërkesave buxhetore bazuar në çmimet e tregut.
2.	Planifikimi i buxhetit të pa mjaftueshëm	Dështimi për të përfshirë të gjitha kërkesat dhe nevojat për financim	Mos përmbushja e nevojave Mos kryerja e shërbimeve komunale	4	3	12	Lartë Koordinim më efektiv i departamentit të buxhetit dhe drejtorive dhe programeve buxhetore gjatë procesit buxhetor


Mundësia	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2 - Pak e mundur	3-Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5-Pothuajse e sigurt
Ndikimi	1- Të pa përfllishme	2-Të vogla	3-Modëruara	4-Të mëdha	5-Katastrofike
Rezultati	0 - 5 Rreziku i ulët	6 --10 Rreziku i mesëm	12 - 16 Rreziku i lartë	20 - 25 Rreziku ekstrem	
Rangimi	1-Ujët Mesëm Lartë				


		Vlerësimi jo i sakët i kostove	Dëshitimet e procedurave dhe nevoja për përsëritjen e tyre					Vlerësimi i kostove të kërkesave buxhetore bazuar në çmimet e tregut.
3.	Buxhet jo në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës	Kuptimi i dobët i objektivave strategjike komunale nga stafi i përfshirë në proces të buxhetit Paraqitja e objektivave të reja dhe interesimi i menaxhmentit për financimin e projekteve ad-hoc jashtë fushave prioritare	Dështimi për të realizuar objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës Shpenzime jo efektive dhe mungesa e buxhetit për financimin e nevojave prioritare Dështimi për të përmbush pritjet e qytetarëve	3	3	9	Mesëm	Përdorimi i objektivave dhe prioritetëve strategjike të komunës të vendosura në dokumente strategjike dhe Kornizë Afatmesme e Buxhetit si bazë për buxhetim Përgatitja e KAB në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës si dhe përdorimi i KAB si dokument bazë gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor
4.	Buxheti jo gjithëpërfshirës i cili nuk adreson kërkesat dhe nevojat e qytetarëve	Mos përfshirja e qytetarëve në procesin e përgatitjes së buxhetit Dështimi për të organizuar dëgjime publike apo pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në dëgjime buxhetore Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve nuk merren parasysh gjatë procesit buxhetor	Mos adresimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve Humbja e besimit të qytetarëve ndaj administratës komunale Rënje e interesit të qytetarëve për të paguar taksat komunale	3	3	9	Mesëm	Mbajtja e dëgjimeve të mjaftueshme publike me përfaqësuesit e të gjitha vendbanimeve Marrja në konsideratë e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve përfshirë të gjitha grupet marginalizuara gjatë procesit buxhetor. Çasje aktive në informimin e qytetarëve për pjesëmarrje në dëgjimet publike gjatë procesit buxhetor.
5.	Mos aprovimi i buxhetit nga Kuvendi Komunal	Buxheti nuk përfaqëson nevojat dhe kërkesat e komunitetit që përfaqësojnë asamblistët	Komuna dështon të realizojë të gjitha projektet kapitale të planifikuara etj.	1	5	5	Ulët	Përgatitja e buxhetit duke ndjekur një proces gjithëpërfshirës dhe transparent që adreson pritjet e qytetarëve dhe nevojat e komunës për zhvillim

4. PROCESI I BUXHETIT KOMUNAL: DIAGRAMI I PROCESIT










Buxheti ka mospërputhje me kufijtë buxhetor dhe nuk aprovohet

Buxheti ka mosperputhje me bujqesë buxhetor dhe nuk aprovohet



II. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE

1. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Titulli i procesit:	Procesi i Menaxhimit të Pagave
Organizata Buxhetore:	Komuna
Data e rishikimit:	<DATA>
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	Procesi ka për qëllim përshkrimin e procedurave të menaxhimit të pagave në komunë duke përfshirë fazat si krijimi i punonjësve të rinj, koha dhe vijueshmëria, menaxhimi i listës së pagave, kalkulimi i pagave, pagesat e pagave dhe barazimet.
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Komuna
Versioni:	V. 01/2018
Korniza ligjore:	
Pronari i Procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i Komunës 2. Menaxheri i Personelit
Palët e përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i Komunës 2. Punonjësit 3. Menaxheri i BNJ 4. Drejtorët e Drejtorive Përkatëse 5. Thesari (divizioni i pagave) 6. Zyrtari i shpenzimeve 7. Ministria e Administratës Publike (MAP) 8. Banka Qendrore e Kosovës (BQK)
Sistemet e TI të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. E-Mail 2. SIMBNJ 3. SMVP
Dokumentet e përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Formulari standard i aplikimit 2. Akt emërimi 3. Kontrata 4. Dokumenti elektronik për punonjës të rinj 5. Kartela Magnetike për qasje në punë 6. Listat e vijueshmërisë 7. Urdhëresa për punë jashtë orarit 8. Formulari i aprovimit të orët e punuara jashtë orarit të rregullt 9. Raportet e vijueshmërisë në punë 10. Dokumentet mbështetëse (raportet mjekësore, etj.) 11. Lista elektronike e punonjësve 12. Urdhri për pagesë 13. Urdhërpagesa 14. Pagesat e kthyer (dokument elektronik)
Ndërlidhja:	Procesi i Buxhetit
Numri i hapave:	26

2. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE: PROCESI NË DETAJ

Procesi i Menaxhimit të Pagave						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet e gjeneruara	Sistemet
Nën-Procesi: Krijimi i punonjësve të rinj						
1.	Regjistrimi i të dhënave të punonjësve të rinj në sistem të BNU	<p>1.1 Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësit të rinj, çdo punonjës i sapo punësuar ka plotësuar të dhënat e tij/saj personale në formatin standard të aplikacionit të BNU (emri, mbiemri, datëlindja, numrin e letërnjoftimit, vendndodhjen, kombësinë, statusin civil, adresën, edukimi, profesioni, kualifikimet etj.)</p> <p>1.2 Të dhënat e plotësuara nga punonjësit dërgohen tek BNU dhe inkuorohen ne SIMBNU.</p>	1. Çdo punonjës	Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit	<p>1. Të dhënat individuale dhe komponentët e pagës</p> <p>2. Aplikimi për transferin bankar</p> <p>3. Formulari standard i aplikimit</p>	Në letër
2.	Përgatitja e Akt emërimit nga Burimet Njerëzore	2.1 Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësit të rinj, çdo punonjës i sapo emëruar plotëson të dhënat e tij/saj personale në formatin standard të BNU (emri, mbiemri, datëlindja, numrin e letërnjoftimit, vendndodhjen, kombësinë, statusin civil, adresën, edukimi, profesioni, kualifikimet etj.)	1. Menaxheri i BNU	Nuk ka	1. Akt emërimit e punonjësit të ri	Në letër

		2.2 Menaxheri i BNU përgatitë akt emërimin të punonjësit të ri në përputhje me katalogun e vendeve të punës dhe shpalljen.				
		2.3 Menaxheri i BNU e dërgon letrën e akt emërimin tek Kryetari i Komunës për nënshkrim				
3.	Nënshkrimi i kontratës me punonjësin e ri	3.1 Kryetari i komunës: <ul style="list-style-type: none"> Nënshkruan akt emërimin; Nënshkruan kontratën e punës me punonjësin e ri; dhe 	1. Kryetari i Komunës	Brenda 30 ditëve pas rekrutimit	1. Akt emërimi i punonjësit të ri 2. Kontrata	1. Në letër 2. SIMBNU
4.	Dërgimi i dokumentacionit të punonjësve të rinj në MAP dhe regjistrimi i tyre në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNU)	4.1 Zyrtari i BNU: <ul style="list-style-type: none"> Skanon të gjitha dokumentet dhe i regjistron në SIMBNU, ndërsa kopjet e dokumenteve të nvojshme i dërgon ato tek zyrtarët në MAP; dhe Për qëllime të brendshme, krijon një bazë të thjeshtë të dhënash për punonjësit me informata si (emrin e institucionit, lokacionin, departamentin, emrin mbiemrin, diplomat e fituara, datëlindjen, pozitën dhe shkallën e gradën e pagës) 	1. Zyrtari përgjegjës i BNU 2. MAP	Nuk ka	1. Dokumentin elektronik për punonjës të rinj 2. Formulari për punëtorë të rinj	1. SIMBNU
Nën-procesi: Koha dhe vijueshmëria						
5.	Regjistrimi i punonjësve të rinj në Sistemin për Menaxhimin dhe	5.1 Zyrtari i burimeve njerëzore informon departamentin e IT për stafin e ri	1. Zyrtari i BNU	Nuk ka	1. Baza e dhënave për vijueshmërinë në punë	SMVP

	Vijueshmërinë në Punë (SMVP)	5.2 IT regjistron të dhënat personale të punonjësve të rinj në SMVP.			
6.	Aprovimi i të dhënave për punonjësit e rinj në SMVP dhe krijimi i kartelës magnetike për regjistrimin e kohës	6.1 Menaxheri i BNU j kontrollon dhe aprovon të dhënat e futura nga zyrtari i burimeve njerëzore në SMVP. 6.2 Menaxheri i BNU krijon kartelën magnetike për regjistrim të vijueshmërisë dhe e pajis punonjësin e ri për qasje në vend të punës.	1. Zyrtari BNU	Nuk ka	1. Kartela magnetike SMVP
7.	Regjistrimi manual i vijueshmërisë në punë (aty ku nuk aplikohet sistemi SMVP – ku ka prishje)	7.1 Menaxheri i drejtorisë përkatëse përgatitë dhe printon listat e hyrje daljes në baza ditore 7.2 Menaxheri i drejtorisë përkatëse i vendosë listat në vend të përshtatshëm për nënshkrim.	1. Drejtori i drejtorisë përkatëse 1. Çdo punonjës	NA	1. Lista e vijueshmërisë Letër
		7.3 Drejtori i drejtorisë përkatëse i			

		dërgon listat e nënshkuara të vijueshmërisë në punë tek BNJ.				
8.	Evidentimi i nevojës për punë jashtë orarit dhe para autorizimi	8.1 Drejtori i drejtorisë përkatëse evidenton nevojën dhe pajtohet për punë jashtë orarit. 8.2 Drejtori i drejtorisë përkatëse autorizon kryerjen e punëve jashtë orarit përmes plotësimit të formularit "Urdhëresa për Punë Jashtë Orarit"	1. Kryetari i Komunës 2. Drejtori i drejtorisë përkatëse	NA	1. Urdhëresa për Punë jashtë Orarit	Në letër
9.	Konfirmimi i punës jashtë orarit	9.1 Në rast të orëve shtesë jashtë orari të kryera nga stafi, drejtori i drejtorisë kontrollon: <ul style="list-style-type: none"> • Nëse orët shtesë të kryera bazohen në urdhëresën për punë shtesë jashtë orarit; dhe • Nëse puna zbatohet në përputhje me urdhëresën; 9.2 Drejtori i drejtorisë përkatëse zyrtare për aprovim të punëve të kryera jashtë orarit nga Kryetari i Komunës.	1. Drejtori i drejtorisë përkatëse/udhëheqësi i njësisë	Pasi puna të kryhet	1. Formulari i aprovimit për orët e punuara jashtë orarit të punës	Në letër
10.	Raportimi i vijueshmërisë	10.1 Sipas kërkesës, menaxheri i BNJ gjeneron raporte mujore për vijueshmërinë e përditshme të çdo punonjësi të grupuara në drejtori. Raportet gjenerohen në SMVP ose listave të nënshkuara të vijueshmërisë (ku nuk përdoret SMVP).	1. Menaxheri i BNJ	NA	1. Raportet e gjeneruara të vijueshmërisë	1. SMVP

11. Konfirmimi i vijueshmërisë	<p>11.1 Drejtori i drejtorisë përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrollon kohën e vijueshmërisë për secilin punonjës; • Siguron dokumentin e arsyetimit mbështetës në rast të mungesës së punonjësit që ka nën mbikëqyrje; dhe • Trajton kërkesat e stafit të tij/saj për ri kalkulim të pagave nga muaji paraprak; <p>11.2 Punonjësi konfirmon ose jo ndryshimet e kohës ose të prezencës</p>	1. Drejtori i drejtorisë përkatëse	Brenda datës 5 së muajit aktual	<p>1. Lista e vijueshmërisë e nënshkruar;</p> <p>2. Dokumentet mbështetëse në rast të mungesës në punë (raporti mjekësor, etj.)</p> <p>3. Rishikimin e kalkulimeve, etj.</p>	E-mail
Nën-procesi: Menaxhimi i Listës së Pagave					
12. Përgatitja e listës së pagave	<p>12.1 Zyrtari i burimeve njerëzore përgatitë të dhënat për listën e pagave përmes formularit për të dhënat për listën e pagave për secilin punonjës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kodin institucional dhe buxhetor; • Lokacionin; • Departamentin; • Emrin dhe mbiemrin e punonjësve • Datëlindjen; • Kodi i pagesës; • Pozita dhe kodi i pagesës; dhe • Koefficienti. 	1. Zyrtari përgjegjës i burimeve njerëzore	Deri me datë 10 të muajit	1. Formulari i të dhënave për listën e pagave për secilin punonjës	1. SIMBNJ

13.	Përfshirja e ndryshimeve dhe pagave retroaktive në listën e pagave	<p>13.1 Për ndryshimet gjatë muajit dhe pagesat retroaktive, zyrtari i BNU:</p> <p>13.2 Kontrollon dokumentet e pranuar të cilat autorizojnë ndryshimet; dhe</p> <p>13.3 Përgatitë një dokument të veçantë me të dhënat shtesë lidhur me</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zërin e ndryshuar në FDHLLP; • Arsyetimin për ndryshimin përkatës; dhe • Datën e ndryshimit. 	1. Zyrtari i BNU	Deri me datë 10 të muajit vijues	<p>1. Lista e ndryshimeve e krijuar nga zyrtari i BNU</p> <p>2. Dokumentet mbështetëse (urdhri nga Kryetari i Komunës)</p> <p>3. Lista vijueshmërisë apo dokumenti i nënshkruar nga udhëheqësi i drejtorisë</p> <p>4. Raportet mjekësore, etj.</p>	1. Në letër
14.	Aprovimi i listës së pagave nga menaxheri i BNU	<p>14.1 Menaxheri i BNU:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kryen kontrollin e dytë të formularit me të dhënat për pagat dhe listës së ndryshimeve (kontrolli i dokumenteve të bashkëngjitura të cilat dëshmojnë ndryshimet); • Konsultohet me ZKF nëse ka buxhet të alokuar në rast të orëve jashtë orarit të punës; • Aprovon dokumentet e përgatitura nga zyrtari i burimeve njerëzore; dhe 	1. Menaxheri i BNU	Brenda datës 10 të muajit vijues	5. Dokumentet e dërguara në thesar	1. Në letër

		<ul style="list-style-type: none"> Në rast se nuk ka fonde për pagesë të orëve shtesë, ai/ajo kalkulon shumën përkatëse dhe i shndërron në ditë pushimi. 				
	14.2	Menaxheri i BNJ i dërgon dokumentet në thesar (divizioni i pagave) së bashku me referencat bankare.				
15.	Kontrollimi nga Thesari (divizioni i pagave)	<p>15.1 Zyrtari përgjegjës i thesarit (divizioni i pagave) kontrollon:</p> <ul style="list-style-type: none"> Dokumentet e pranuar dhe i protokollon ato; Regjistron FDHLP në sistem (një here në muaj) dhe regjistron listën me ndryshime në SIP; Kontrollon fizikisht dokumentet mbështetëse për punonjësit e rinj si kontratën, letër emërimin, etj.; Ushtron kontrolle nëse punonjësi ka më shumë se dy vende të punës në administratë (lejohet vetëm një page primare dhe 1 sekondare); Ushtron kontroll të dyfishtë me ATK për të dhënat e punonjësve prej regjistrit civil (thesari ka gjasë direkt në sistemin e taksave ku bashkëlidh me listën e punonjësve) 	1. Thesari (divizioni i pagave)	Nga data 11-18 të muajit	<p>1. Lista e protokollit të dokumenteve</p> <p>2. Lista elektronike e punonjësve publik</p>	Në SIMFK
Nën-procesi: Kalkulimi i pagave						

16.	Kontrolli buxhetor	<p>16.1 Zyrtari i thesarit siguron:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrollin automatik të buxhetit përmes sistemit (kontrollon numrin e punonjësve për secilin drejtor kundrejt numrit total të aprovuar në buxhet); • Kalkullimin automatik të pagave; dhe • Gjenerimin e listës së pagave në sistemin e pagave (në hollësi përfshirë orët jashtë orarit dhe bonuset) për secilin punonjës dhe të gjitha zbritjet lidhur me sigurimet sociale, tatimin në të ardhura, pagesat e sindikatave, etj. 	1. Thesari (divizioni i pagave)	NA	NA	1. SIMFK
17.	Nënshkrimi i listës së pagave	<p>17.1 Menaxheri i BNU printon listat e pagave nga sistemi i pagave dhe ua dërgon drejtorive përkatëse. <i>(Menaxheri i BNU ka çasje në sistemin të pagave në thesar)</i></p> <p>17.2 Secili punonjës nënshkruan listat e pagave</p> <p>17.3 Drejtori i drejtorisë përkatëse i dërgon listat e nënshkuara tek BNU</p> <p>17.4 Menaxheri i BNU dërgon tek ZKF/Zyrtari i shpenzimeve listat e pagave dhe urdhrin për pagesë</p>	1. Menaxheri i BNU	Nga data 23 -25 e muajit	1. Listat e pagave të firmosura 2. Urdhri për pagesë	1. Në letër

18.	Kontrollimi/korrigjimi i pagës në listë të pagave	18.1 Çdo punonjës e kontrollon pagën e tij (kalkulimi, ndalesat, etj.) dhe në rast të mos pajtimit mund të bëjë kërkesë për rishikim të pagës të cilën e dërgon tek menaxheri i BNU	1.Çdo punonjës	Në muajin pasues	1. Kërkesë për rishikim të kalkulimit të pagës	E-mail ose në fletër
19.	Regjistrimi i shpenzimeve të pagave në SIMFK	19.1 Zyrtari i shpenzimeve merr listën e pagave dhe urdhrin për pagesë nga menaxheri i BNU dhe i firmos së bashku me Kryetarin e Komunës. 19.2 Zyrtari i shpenzimeve regjistron shumën totale të pagave në SIMFK	1. Zyrtari i shpenzimeve	NA	1. Listat e pagave 2. Urdhri për pagesë	1. Në fletër
Nën-procesi: Pagesat e Pagave dhe barazimet						
20.	Kontrolli i listës së pagave nga njësia e pagesave në Thesar	20.1 Pas pranimit të listës së pagave të komunës, zyrtari i thesarit përgjigjet për pagesa kontrollon: <ul style="list-style-type: none"> • Numrin total të punonjësve dhe shumën totale të pagave kundrejt buxhetit vjetor dhe alokimit mujor për pagat. 20.2 Njofton ZKF në rast se mungojnë fondet në SIMFK 20.3 Pas pranimit të njoftimit për mungesë të fondeve, ZKF: <ul style="list-style-type: none"> • Rishikon planin e parasë së gatshme (alokimi i fondeve); dhe • Në rast se shuma e pagave për t'u paguar është më e vogël gjatë muajit dhe bën rregullimet e 	1. Thesari njësia e pagesave	24 - 30 të muajit vijues	1. Plani i alokimit mujor i rishikuar	1. SIMFK

	nevojshme					
21.	Përgatitja e pagesës së pagave	<p>21.1 Pas kontrollit të kryer nga njësia e pagesave, zyrtari i Thesarit për paga përgatitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Blloqe të vecanta pagesash (files) për secilën bankë komerciale; dhe • Transferet bankare në llogaritë e punonjësve. 	1. Thesari	Dita e parë e punës muajit në vijim	1. Pagesat elektronike	1.SIMFK-SIP
22.	Aprovimi i pagesës së pagave nga Drejtori i Thesarit dhe ekzekutimi i tyre	<p>22.1 Zyrtari i Thesarit përgjegjës për pagësa përgatitë urdhër pagesat (shumat totale) për çdo bankë komerciale;</p> <p>22.2 Drejtori i Thesarit aprovon urdhër pagesat;</p> <p>22.3 Zyrtari i Thesarit për pagesa dërgon në BOK për ekzekutim transferin e parasë së gatshme në secilën bankë komerciale; dhe</p> <p>22.4 Zyrtari përgjegjës i Thesarit regjistron shpenzimet dhe pagesën e pagave në SIMFK;</p>	1. Thesari	Deri në fund të muajit	1. Urdhërpagesa	1. Në letër 2. SIMFK

23.	Kontrolli i ekzekutimit të pagave dhe barazimi i gabimeve	23.1 Thesari (Divizioni i Pagesave): 23.2 Merr pasqyrën e gjendjes ditore të LFK nga BOK së bashku me dokumentin elektronik të gabimeve (në rast të pagesave të kthjera mbrapsht) dhe njofton organizatën buxhetore; dhe • Bën barazimet ndërmjet sistemeve të SIMFK dhe BOK-së si dhe ndërmjet SIMFK dhe sistemit të pagave	1. Thesari	Maksimumi në ditën në vijim	1. Pagesa të kthjera (Dokumentet elektronike)	1. SIMFK-SIP
24.	Trajtimi i gabimeve në transfer të pagave nga Komuna	24.1 Zyrtari i shpenzimeve: • Gjeneron raportin e pagesave ditore; dhe • Printon dokumentin e gabimeve (pagesave të kthjera) 24.2 Zyrtari i shpenzimeve e dërgon dokumentin e gabimeve të Menaxheri i BNI	1. Zyrtari i shpenzimeve	Çfarëdo kohe pas datës 1 të muajit	1. Dokumenti i gabimeve (pagesave të kthjera)	1. SIMFK
25.	Korrigjimi i gabimeve të transferit të pagave nga Komuna	25.1 Menaxheri i BNI: • Ndjek hapat e përshkuara më sipër në pjesën Menaxhimi i Listës së Pagave; dhe • Parqet pagesat retroaktive në listën e ndryshimeve të muajit vijues.	1. Menaxheri i BNI	Nuk ka	1. Lista e ndryshimeve në Thesar (divizioni i pagave)	E-mail ose letër

Fundi i procesit të Menaxhimit të Pagave

3. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE: LISTA E RREZIQEVE

REGJISTRI I RREZIQEVE PËR KOMUNËN E ISTOGUT

Procesi i menaxhimit të pagave

NR. RREZIKUT	PËRSHKRIMI I RREZIKUT	SHKAKU I RREZIKUT	PASOJAT	VLERËSIMI I RREZIKUT				VEPRIMET E NEVOJSHME PËR ZBUTJEN E RREZIKUT
				Mundësia	Ndikimi	Rezultati	Rangimi	
1	Dështimi për të punësuar dhe ruajtur stafin e kualifikuar dhe me përvojë në fusha deficitare	Buxhet i limituar për kompensim të stafit Rekrutimi i stafit jo në bazë të meritës Mundësi të limituara për zhvillim profesional dhe avancim në karrierë	Shërbime të cilësisë së dobët Dështimi në realizimin e objektivave komunale Mungesa e ekspertizës së brendshme dhe nevoja për të kontraktuar shërbimet nga jashtë	3	3	9	Mesëm	Përmirësimi i kontrollleve gjatë rekrutimit të stafit Krijimi i mundësive për zhvillim profesional dhe avancim në karrierë Angazhimi i stafit profesional dhe të pavarur në komisione të rekrutimit Zhvillimi i kriterëve objektive të përzgjedhjes dhe zbatimi i tyre gjatë rekrutimit
2	Mungesa e stafit në punë dhe mos respektimi i orarit të punës	Mungesa e llogaridhënies dhe kontrole jo efektive Mungesa e mekanizmave për monitorimin dhe raportimin e vijueshmërisë Mos zbatimi i ndëshkimeve të parapara me legjislacion	Vonesa në kryerjen e punëve dhe ofrimin e shërbimeve Dëmtim i buxhetit Vonesat dhe mungesat e përsëritura bëhen shprehë nga stafi Ndikim negativ tek stafi që	4	3	12	Lartë	Përmirësimi i kontrollleve të vijueshmërisë Zbatimi i ndalesave në pagë për mungesat e pa arsyetura Zbatimi i masave disiplinore

Mundësia 1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe 2- Pak e mundur
Ndikimi 1- Të pa përfllishme 2- Të vogla
Rezultati 0- 5 Rreziku i ulët 6- 10 Rreziku i mesëm
Rangimi 1- Ulet 2- Mesëm

3- Ka mundësi 3- Moderuara 12- 16 Rreziku i lartë
4- Me shumë mundësi 4- Të mëdha 20- 25 Rreziku ekstrem
5- Pothuajse e sigurt 5- Katastrofike

3	Procesim i gabueshëm i pagave në listë të pagave	Procesim manual i të dhënave	respekton orarin e punës	2	3	6	Mesëm	Forcimi i kontroleve gjatë procesimit të pagave
		Kontrolle jo efektive për parandalimin apo zbulimin e gabimeve		Mbi pagesa dhe dëmtim i buxheit				Kontrolli i fundit i listës para procesimit të pagave
		Pakujdesia gjatë procesimit të pagave apo veprime të qëllimshme						Trajnimi i duhur i stafit për procesimin e pagave
4	Rrjedhja dhe keqpërdorimi i pa autorizuar i të dhënave personale të të punësuarave	Çasje e pa autorizuar në të dhënat personale	Keqpërdorimi i të dhënave personale nga palët e treta	4	4	16	Lartë	Forcimi i kontroleve të teknologjisë informative
		Shpalosja e qëllimshme e të dhënave personale	Keqpërdorimi i llogarive bankare të stafit					Limitimi i çasjes në dhënat personale
		Mungesa e kontroleve të duhura të teknologjisë informative	Cenimi i privatesisë së stafit					Trajnimi i stafit në ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale
			Humbja e besimit dhe dëmtimi i reputacionit të komunës					Kujdes i shtuar i stafit përgjegjës gjatë procesimit dhe ruajtjes së të dhënave personale
5	Keqpërdorimi i apo shfrytëzimi i tejkaluar i pagesave për punë jashtë orarit	Dështimi për të kalkuluar sakët dhe monitoruar orët jashtë orarit	Pagesa për punë të pa kryera	4	3	12	Lartë	Sigurimi që kërkesa dhe aprovimi të bëhet para fillimit të punës
		Punë jashtë orarit pa kërkesë apo aprovim paraprak	Dëmtim i buxheit					Verifikimi i orëve të punuara dhe rezultateve të punëve para kryerjes së pagesave
		Mblidhëqyrje e dobët e punëve dhe pagesave për punët jashtë orarit						
6	Mos vlerësimi i performancës së punës	Kuptimi i dobët i rëndësisë së vlerësimit të performancës	Dështimi për të identifikuar performancën e dobët dhe nevojave për zhvillim dhe trajnim	3	4	12	Lartë	Hartimi i një plani për kryerjen e vlerësimit të rregullt të performancës së stafit dhe zbatimi i tij
		Mos interesimi i menaxhmentit për vlerësimin e performancës	Dështimi për të identifikuar					

Mundësia 1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe 2- Pak e mundur
 Ndikimi 1- Të pa përfllshme 2-Të vogla
 Rezultati 0 - 5 Rreziku i ulët 6 - 10 Rreziku i mesëm
 Rangimi 1 Uletë 1 Mesëm

3-Ka mundësi 3-Moderruara 4-Me shumë mundësi
 4-Të mëdha 20 - 25 Rreziku ekstrem

5-Pothuajse e sigurt
 5-Katastrofike

	Mungesa aftësive për vlerësim objektiv të performancës	performuesit e mirë					Trajtimi i stafit për kryerjen e vlerësimit të performancës	
		Avancimi i stafit jo i bazuar në performancë dhe rezultate në punë					Promovimi i një kulture organizative të bazuar në performancë	
		Mos zbatimi i kërkesave ligjore për vlerësim të performancës në punë						
7	Rekrutimi/avancimi apo pagesa e stafit bazuar në dokumentacion të pa verifikuar	Veprimet e qëllimshme	Rekrutimi i stafit jo adekuat	2	4	8	Mesëm	Përfshirja e kërkesave për verifikim të dokumentacioneve gjatë rekrutimit përfshirë kontaktin me lëshuesit e dokumentacionit
		Kontrolle të pa mjaftueshme	Mos kryerja e punëve apo kryerja e tyre të cilësisë së dobët					Kujdesi i shtuar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit
		Pakujdesia e stafit gjatë procesit	Ankesa ndaj procesit të rekrutimit					Kërkesa për dokumentacion shtesë
			Dëmtimi i reputacionit të komunës					

Mundësia 1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe
 Ndikimi 1- Të pa përfllishme
 Rezultati 0 - 5 Reziku i ulët


2 - Pak e mundur
 2-Të vogla
 6 - 10 Reziku i mesëm

3-Ka mundësi
 3-Modera
 12 - 16 Reziku i lartë


4-Me shumë mundësi
 4-Të mëdha
 20 - 25 Reziku ekstrem


5-Pothuajse e sigurt
 5-Katastrofike


Rangimi 1. Ulët
 1 Mesëm
 1 lartë



4. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE: DIAGRAMI I PROCESIT







III. PROCESI I KONTRATAVE PËR SHËRBIME ME MARRËVESHJE TË VEÇANTA

1. PROCESI I KONTRATAVE PËR SHËRBIME ME MARRËVESHJE TË VEÇANTA: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Titulli i procesit:	Procesi i angazhimit të stafit përmes kontratave për shërbime me marrëveshjeve të veçanta
Organizata Buxhetore:	Komuna
Data e rishikimit:	<DATA>
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi / e procesit:	Procesi ka për qëllim përkrahimin e procedurave të angazhimit të stafit me kontrata për marrëveshje për shërbimeve të veçanta, shpalljes, procesi përkrahuan procedurat prej fazës së planifikimit, shpalljes, përzgjedhjes, angazhimit dhe monitorimit.
Përfjetjesi për rishikim të procesit:	Ministria e Administratës Publike
Versioni:	V. 01/2018
Korniza ligjore:	1. Buxheti komunal 2. Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil 3. Rregullore Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil 4. Ligji Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve
Pronari i Procesit:	Menaxheri i Burimeve Njerëzore
Palet e përfshira në proces:	1. Kryetari i Komunës 2. Drejtorët e Drejtorive Përkatëse 3. Drejtori për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesor Financiar 4. Menaxheri i Burimeve Njerëzore 5. Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve 6. Përfituesit i Kontrates
Sistemet e TI të përfshira në proces:	1. E-Mail 2. SIMFK
Dokumentet e përfshira në proces:	1. Buxheti i stafit për shërbime me marrëveshje për shërbime të veçanta 2. Kërkesa për angazhim e stafit me marrëveshje me shërbime të veçanta 3. Formulari për aplikim 4. Shpallja e publikuar 5. Lista e aplikantëve 6. Vendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për Vlerësim të Aplikacioneve 7. Shablioni i testit me shkrim 8. Raporti i rezultateve të testi me shkrim 9. Propozimi i personit për angazhim për pozite 10. Kontrata e angazhimit me marrëveshje për shërbime të veçanta
Ndërlidhja:	1. Procesi i buxhetit 2. Procesi mallrave dhe shërbimeve
Numri i hapave:	16

2. PROCESI I KONTRATAVE PËR SHËRBIME ME MARRËVESHJE TË VEÇANTA: PROCESI NË DETAJ

Procesi i angazhimit të stafit përmes kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta						
Hapat	Aktivitetet	Aktivitetet e kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet e gjeneruara	Korniza ligjore
1.	Planifikimi buxhetor për angazhim të personelit me marrëveshje për shërbime të veçanta	<p>1.1. Gjatë planifikimit buxhetor, drejtorët e drejtorive përkatëse duhet të parashohin:</p> <p>1.1.1. Nevojtat specifike për shërbime të veçanta sipas planit të tyre strategjik dhe të punës për vitin vijues.</p> <p>1.1.2. Numrin e stafit të nevojshëm për angazhim me kontrata me marrëveshje për shërbime të veçanta (më pak se 6 muaj).</p> <p>1.1.3. Rezultatet e pritura të punës të stafit të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta.</p> <p>1.1.4. Koston e përafërt të angazhimit të stafit dhe kualifikimet e nevojshme për të ekzekutuar detyrat e kontratës së parapare.</p> <p>1.1.5. Buxhetimin për koston e punësimit të personelit nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta.</p>	<p>1. Drejtorët e Drejtorive përkatëse</p> <p>2. ZKF / Drejtori për Financa</p> <p>3. Kryetari i Komunës</p>	<p>Jo më vonë se para datës së pranimit të qarkores se parë buxhetore për vitin vijues</p>	<p>1. Buxhet preliminar për staf me marrëveshje për shërbime të veçanta</p>	<p>1. Buxheti komunal (Komuna e Istogut)</p>
2.	Arsyeshimi i nevojës për staf me marrëveshje për shërbime të veçanta	<p>2.1. Drejtori i Drejtorisë përkatëse, me ndihmën e Menaxherit të Burimeve Njerëzore (BNJ), përgatitë Kërkesën për Angazhimin e Stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta.</p> <p>2.2. Kërkesa duhet të përfshijë së paku këto informata:</p> <p>2.2.1. Arsyet për nevojën për të angazhuar</p>	<p>1. Drejtori i Drejtorisë përkatëse</p> <p>2. Menaxheri i Burimeve Njerëzore (BNJ)</p>	<p>Nuk ka</p>	<p>1. Kërkesa për Angazhimin e Stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta.</p>	<p>1. Ligji Nr. 03/L -149 për Shërbimin Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p>

		<p>staffin nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta;</p> <p>2.2.2. Arsyet përse shërbimet nuk mund të kryhen nga kapacitetet e brendshme të Komunës;</p> <p>2.2.3. Problemet dhe mundësitë e humbura që mund të rriëdhin nga mos-përmbyshja e kërkesës për angazhim të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta;</p> <p>2.2.4. Periudha kohore për përfundimin e angazhimit të stafit;</p> <p>2.2.5. Kohëzgjatja e pritur e angazhimit të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta (1 deri në 6 muaj); dhe</p> <p>2.2.6. Përshkrimin e përgjegjësiëve të angazhimit dhe kërkesat minimale të kualifikimeve dhe eksperiencës.</p>				
3.	<p>Aprovimi i kërkesës nga Kryetari i Komunës</p>	<p>3.1. Drejtori i Drejtorisë përkatëse dërgon kërkesën për angazhim të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta të Kryetari i Komunës për aprovim.</p> <p>3.2. Kryetari i Komunës shqyrton kërkesën dhe aprovon ose refuzon atë.</p> <p>3.3. Nëse kërkesa aprovohet, kërkesa dërgohet të Njësia për Burime Njerëzore për procedurë të rekrutimit.</p> <p>3.4. Nëse kërkesa refuzohet, procesi ndaloëhet dhe duhet të fillojë nga pika 2.</p>	<p>1. Drejtori i Drejtorisë përkatëse</p> <p>2. Kryetari i Komunës</p>	Nuk ka	<p>1. Kërkesa për Angazhimin e Stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e aprovuar</p>	<p>1. Analogjia sipas Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p>
4.	<p>Përgatitja e Formularit për</p>	<p>4.1. Menaxheri i BNI përgatitë formularin për aplikim që do të përdoret nga aplikantët.</p>	<p>1. Menaxheri i BNI</p>	Nuk ka	<p>1. Formulari për aplikim</p>	<p>1. Analogjia sipas</p>

<p>Aplikim për angazhim me marrëveshje për shërbime të veçanta</p>	<p>4.2. Formulari duhet të jetë në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.</p>			<p>Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil <u>[Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës].</u></p>
<p>5. Përgatitja e shpalljes për angazhim të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta.</p>	<p>5.1. Menaxheri i BNU përgatit shpalljen e konkursit për angazhim të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta sipas kërkesave të rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil.</p> <p>5.2. Shpallja duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të bazës ligjore që rregullon angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta.</p> <p>5.3. Kohëzgjatjen e angazhimit (0 – 6 muaj).</p> <p>5.4. Datën e mbylljes së konkurrit dhe informata mbi datën e fundit për dorëzimin e aplikacioneve (e cila duhet të jetë më së paku 8 ditë kalendarike nga data e publikimit në mjete të informimit publik).</p>	<p>1. Menaxheri i BNU</p>	<p>Nuk ka</p>	<p>1. Shpallja nëpërmjet formës Form.MAP-SHK-02 (të modifikuar)</p> <p>1. Analogjia sipas Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil <u>[Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës].</u></p>
<p>6. Publikimi i Shpalljes</p>	<p>6.1. Komuna publikon shpalljenë me die elektronike, në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen zyrtare të Komunës.</p>	<p>1. Zyrtari përgjegjës për komunikim me publikun</p>		<p>1. Shpallja e pozitës publikuar</p> <p>1. Analogjia sipas Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në</p>

					Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)	
7.	Pranimi i aplikacioneve	<p>7.1. Menaxheri i BNU ose zyrtari i autorizuar i tij pranon aplikacionet qoftë në formë të shtypur të cilat janë dorëzuar nga kandidatët në Qendërën për Shërbime me Qytetarë (QSHQ).</p> <p>7.2. Pas mbylljes së afatit të konkurrimit, QSHQ i dërgon aplikacionet të Njësia e Personelit apo zyrtari i autorizuar i tij.</p> <p>7.3. Njësia e Personelit krijon regjistrin e aplikacioneve të pranura.</p>	1. Menaxheri i BNU ose zyrtari i autorizuar i tij	Pas mbylljes së afatit të konkurrimit	1. Lista e aplikantëve	1. Analogjia sipas Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
8.	Krijimi i Komisionit Vlerësues	<p>8.1. Menaxheri i BNU bën propozimin e formimit të komisionit prej minimum tre (3) personave për Komisionin e Vlerësimit të Aplikacioneve.</p> <p>8.2. Menaxheri i BNU e dërgon propozimin për Komision të Vlerësimit të Aplikacioneve të Kryetari i Komunës.</p> <p>8.3. Kryetari i Komunës bën aprovimin apo refuzimin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Aplikacioneve.</p> <p>8.3.1. Në rast të mos-aprovimit, Kryetari i</p>	1. Kryetari i Komunës 2. Menaxheri i BNU apo zyrtari i autorizuar i tij	Deri në 5 ditë pas mbylljes së afatit të fundit për aplikim	1. Vendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Aplikacioneve.	1. Analogjia sipas Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)

		<p>Komunës ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e një apo më shumë anëtarëve të komisionit.</p> <p>8.4. Vendimi i formimit të komisionit i dërgohet anëtarëve të komisionit për Vlerësim të Aplikacioneve.</p>				
9.	Shqyrtimi i aplikacioneve dhe krijimi i listës së ngushtë	<p>9.1. Pas pranimit të vendimit për formimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikacioneve, komisioni vlerësohet cakton mbledhjen brenda 3 ditëve të punës.</p> <p>9.2. Bazuar në kriteret e vendosura në shpallje, komisioni fillon me shqyrtimin e aplikacioneve dhe krijon një listë të ngushtë për të intervistuar me gojë aplikantët duke i ranguar sipas kualifikimit, përvojës së punës, shkathtësive dhe aftësive tjera të përcaktuara.</p> <p>9.3. Komisioni krijon një raport të shkurtër me shkrim për Menaxherin e Personelit përfshirë emrat e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret dhe atyre që nuk i plotësojnë kriteret.</p> <p>9.4. Kandidatët që i plotësojnë kushtet njoftohen për vendin, kohën dhe datën e mbajtjes së testit me shkrim.</p>	1. Komisioni vlerësohet	Pas mbylljes së afatit të aplikimit	<p>1. Raporti për menaxherin e personelit</p> <p>2. Njoftimi për kandidatët që i plotësojnë kushtet</p>	1. Analogjia sipas Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)

10.	Testimi dhe ftesa për testim të kandidatëve [Opsionale]	<p>10.1. Në rast se menaxheri i BNU dhe/ose drejtori i drejtorisë vlerësojnë si të nevojshme testimin me shkrim të kandidatëve, atëherë:</p> <p>10.1.1. Komisioni i Vlerësimit të Aplikacioneve zhvillon formatin e testit dhe vlerësimit të testit sipas analogjisë së Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Neni 33 dhe 36.</p> <p>10.1.2. Menaxheri i BNU sipas listës së komisionit i fton personat në listë të ngushtë në test me shkrim qoftë përmes telefonit dhe/ose e-mail adresës.</p> <p>10.2. Pas testimit me shkrim, Komisioni i Vlerësimit të Aplikacioneve bën vlerësimin e testeve me shkrim sipas nenit 37 të Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.</p> <p>10.3. Komisioni i Vlerësimit të Aplikacioneve, në bazë të vlerësimit të testeve me shkrim, bën një raport të shkurtër me emrat e pjesëmarrësve në testim me shkrim, rezultatet e testimit dhe propozimin e kandidatëve të cilët do të testohen me gojë (intervistë).</p>	<p>1. Menaxheri i BNU</p> <p>2. Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve</p>	Brenda ditëve marrjes listës ngushtë	5 pas së 2. Raporti i rezultateve të testimit me shkrim	1. Analogjia sipas Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
11.	Ftesa për	11.1. Menaxheri i BNU sipas listës së komisionit i	1. Menaxheri i	Nuk ka	1. E-maili i	1. Analogjia

	intervistë për aplikantët në listën e ngushtë	njofton kandidatët pjesëmarrës nëpërmjet publikimit përmes ueb faqes dhe mjeteve elektronike, dhe nëpërmjet e-mail dhe telefonit.	BNJ		dërguar tek personat në listë të ngushtë	sipas Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
11.2.	Menaxheri i BNJ i njofton aplikantët për vendin dhe kohën e intervistës.				2. Publikimi në bordet e lajmërimeve të komunës	
12.	Intervistimi i aplikantëve	12.1. Komisioni për Vlerësimin të Aplikacioneve bën testimin me gojë (intevistimin) të aplikantëve në listën e ngushtë.	1. Komisioni për Vlerësim të Aplikacioneve	Nuk ka	1. Intervistimi i kandidatëve.	1. Analogjija sipas Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
13.	Vlerësimi i aplikantëve në listën e ngushtë	13.1. Pas përfundimit të intervistave, Komisioni për Vlerësim të Aplikacioneve vlerëson intervistat sipas Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Neni 39. 13.2. Komisioni i Vlerësimit të Aplikacioneve, në bazë të vlerësimit të testimit me gojë (intervistave), bën një raport të shkurtër me emrat e pjesëmarrësve në testim me gojë, rezultatet e testimit dhe renditjen e kandidatëve sipas pikëve të fituara.	1. Komisioni për Vlerësim të Aplikacioneve	Nuk ka	1. Raporti i rezultateve të testimit me shkrim 2. Propozimi i personit për angazhim pozitën	1. Analogjija sipas Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
14.	Propozimi për	14.1. Komisioni e dërgon propozimin e	1. Komisioni	Nuk ka	1. Lista me	1. Analogjija

	angazhim	kandidatëve tek Kryetari i Komunës për aprovim dhe angazhim.	për Vlerësim të Aplikacioneve 2. Kryetari i Komunës		kandidatin e propozuar	sipas Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
15.	Vendimi për angazhim	15.1. Kryetari i Komunës bazuar në rekomandimin e Komisionit për Vlerësim të Aplikacioneve bën aprovimin e angazhimit. 15.2. Në rast se Kryetari i Komunës nuk pajtohet me rekomandimin e Komisionit, atëherë Komisioni rishpall procedurën nga hapi 5 i këtij procesi. 15.3. Menaxheri i BNJ shpall rezultatet e procesit të angazhimit të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta në ueb faqen zyrtare të komunës dhe/ose tabelën e shpalljeve të komunës. 15.4. Aplikantët të cilët nuk janë përzgjedhur kanë të drejtë ankese e cila mund të parashtrohet brenda 15 ditëve pas shpalljes publike të rezultateve. 15.5. Në rast të parashtrimit të ankesave,	1. Kryetari i Komunës 2. Komisioni për Vlerësim të Aplikacioneve	Nuk ka	1. Vendimi për angazhim 2. Lista e rezultateve të shpallur 3. Ankesa nga aplikantët [Opsionale] 4. Vendimi për themelimin e komisionit për vlerësim të ankesave	1. Analogjia sipas Rregullores Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)

		komuna duhet të themeloj një komision për shqyrtimin e ankesave dhe të ndërmerr veprime tjera në përputhje me rregulloren 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.				
16.	Nënshkrimi i marrëveshjes	16.1. Menaxheri i BNU dërgon marrëveshjen për shërbime të veçanta për nënshkrim të përfutyesi dhe Kryetari i Komunës. 16.2. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, i përzgjedhuri fillon angazhimin në punë	1. Menaxheri i BNU 2. Kryetari i Komunës 3. Përfutyesi i Kontratës	Brenda ditëve njëjtoimit angazhim	30 pas përfutjes për marrëveshje të veçanta	1. Kontrata e marrëveshjes për shërbime të veçanta 1. Analogjia sipas Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) 2. Ligji Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
Fundi i procesit të angazhimit të stafit përmes kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta						

3. PROCESI I KONTRATAVE PËR SHËRBIME ME MARRËVESHJE TË VEÇANTA: LISTA E RREZIQEVE

REGJISTRI I RREZIQEVE PËR KOMUNËN E ISTOGUT

Procesi i angazhimit të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta

NR. RREZIKUT	PËRSHKRIMI I RREZIKUT	SHKAKU I RREZIKUT	PASOJAT	VLERËSIMI I RREZIKUT				VEPRIMET PËR ZBUTJEN E RREZIKUT
				Mundësia	Ndikimi	Rezultati	Rangimi i rrezikut	
1.	Angazhimi i stafit për pozita të rregullta përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta	Limitet e numrit të punëtorëve dhe buxhetit në ligji të buxhetit	Punësimi jo në përputhje me ligjet dhe rregullat për rekrutim në sektor publik në fuqi	5	4	20		Planifikim më i mirë i nevojës dhe buxhetit të personelit
2.	Angazhimi i stafit për periudhë më të gjatë (deri në 6 muaj) të paraparë me ligji	Nevoja urgjente për staf dhe koha relativisht e shkurtër e angazhimit	Largimi i mundshëm i stafit pas përfundimit të kontratës	Angazhimi i stafit jo më të mirë të mundshëm	4	2	8	Planifikim më i mirë i nevojave dhe i numrit të nevojshëm të stafit në buxhet vjetor
3.	Procedura të rekrutimit të shkurtuara dhe pa konkurrencë të mjaftueshme	Nevoja urgjente për staf	Angazhim i stafit jo adekuat	3	4	12	Lartë	Plotësimi i pozitave kyçe me staf të rregullt të rekrutuar sipas procedurave të rregullta

- Mundësia 1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe
 Ndikimi 1- Të pa përfillshme
 Rezultati 0 - 5 Rreziku i ulët
- 2 - Pak e mundur
 2-Të vogla
 6 - 10 Rreziku i mesëm
- 3-Ka mundësi
 3-Moderruara
 12 - 16 Rreziku i lartë
- 4- Me shumë mundësi
 4-Të mëdha
 20 - 25 Rreziku ekstrem
- 5-Pothuajse e sigurt
 5-Katastrofike
- Rangimi i ulët i Mesëm i lartë


		Mungesa e kapaciteteve të brendshme për mbullim të pozitës përkatëse	Ankesa të mundshme gjatë procesit dhe gjëje të auditimit				Rregullimi i procesit me udhëzime të brendshme
		Proces i pa rregulluar mjaftueshëm dhe mungesa e udhëzimeve të brendshme					Planifikim më i mirë i numrit të nevojshëm të stafit në planin vjetor të personelit
4.	Angazhimi i stafit jo më meritor (sipas kualifikimit, përvojës etj.)	Angazhimi i stafit pa ndjekur ndonjë procedurë të hapur apo sipas procedurave jo transparente Angazhimi bazuar në nepotizëm Mungesa e kriterëve objektive dhe të qarta të rekrutimit Numër i ulët i kandidatëve Mungesa e kërkesave dhe informatave të mjaftueshme në shpalljen publike për profilin e stafit të kërkuar për angazhim	Mos kryerja e shërbimeve apo shërbime të cilësisë së dobët Ankesa të mundshme dhe eventualisht nevoja për përsëritje të procesit Dëmtimi i reputacionit dhe humbja e besimit të qytetarëve	3	4	12	Vendosja e kërkesave dhe kriterëve të qarta dhe objektive në shpallje publike të angazhimit Publikimi i shpalljes në sa më shumë vende dhe kanale të komunikimit për rritjen e numrit të aplikuesve Zhvillimi i procedurave të hapura, transparente, konkurruese dhe vlerësimi i kandidatëve në bazë të kriterëve të vendosura në shpallje publike
5.	Angazhimi i stafit jo në përputhje të plotë me nevojat reale të komunës	Planifikim i dobët i nevojave për staf Kriteret dhe kërkesat e punës të vendosura në shpallje publike nuk përkojnë me nevojat reale të komunës	Mungesa e stafit të duhur në përmesuritë të nevojave reale të komunës Shfrytëzim jo racional i stafit dhe i buxheut dhe pagesa potencialisht të pa nevojshme	3	3	9	Planifikim më i mirë i numrit të nevojshëm të stafit në planin vjetor të personelit Trajnimi i stafit në fushën e planifikimit të


Mundësia 1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe 2- Pak e mundur
 Ndikimi 1- Të pa përfilishme 2- Të vogla
 Rezultati 0 - 5 Reziku i ulët 6 - 10 Reziku i mesëm
 Rangimi 1- Ujët i Mesëm


3- Ka mundësi 4- Me shumë mundësi
 3- Moderuara 4- Të mëdha
 12 - 16 Reziku i lartë 20 - 25 Reziku ekstrem
 1- lartë

5- Pothuajse e sigurt
 5- Katastrofike

4. PROCESI I KONTRATAVE PËR SHËRBIME ME MARRËVESHJE TË VEÇANTA: DIAGRAMI I PROCESIT







IV. PROCESI I SHPENZIMEVE -MALTRA DHE SHËRBIME

1. PROCESI I SHPENZIMEVE - MALLRA DHE SHËRBIME: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Titulli i procesit:	Procesi i Shpenzimeve Publike për Mallra dhe Shërbime
Organizata Buxhetore:	Komuna
Data e rishikimit:	<DATA>
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	<p>Procesi ka për qëllim përkrahimin e procedurave të procesimit të shpenzimeve publike për kategori ekonomike Mallra dhe shërbime. Procesi synon që të sigurojë zbatimin e rregulloreve financiare dhe të sigurojë përputhjen me kërkesat e raportimit financiar sipas rregulloreve në fuqi. Ky proces gjithashtu shënon hallkat vendimmarrëse për proceset e prokurimit publik në rast të shpenzimeve të cilat parashihen të ekzekutohen nëpërmjet procedurave formale të prokurimit publik.</p> <p>Procesi evidenton hallkat vendimmarrëse dhe teknike brenda komunës sa i përket proceseve të ekzekutimit të pagesave dhe regjistrimit në sistemet financiare të TI. Procesi gjithashtu evidenton proceset e komunikimit dhe bashkërendimit me Thesarin e Ministrisë së Financave për ekzekutimin e pagesave.</p>
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Njësia Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave
Versioni:	V. 01/2018
Korniza ligjore:	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148.</p> <p>2. Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042.</p> <p>3. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 03/2014 për Alokimin e Fondeve</p> <p>4. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2010 - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli</p> <p>5. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike .</p> <p>6. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore .</p> <p>7. Ministria e Financave - Doracak i Procedurave</p> <p>8. Procedura e Thesarit për rregullat e gjasës në SIMFK</p> <p>9. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 2 – Delegimi i Përgjegjësi.</p> <p>10. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 5 - Menaxhimi i Pasurive .</p> <p>11. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 6 Autorizimi dhe Pagesat.</p> <p>12. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 11 - Kapitall .</p>
Pronari i Procesit:	<p>1. Për shpenzime që kërkojnë proces të prokurimit: 1.1. Drejtori i Drejtorisë përftuese 1.2. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit</p> <p>2. Për shpenzime që nuk kërkojnë proces të prokurimit: 2.1. Drejtori i Drejtorisë përftuese 2.2. Zyrtari i Shpenzimeve</p>

<p>1. Drejtori i Drejtorisë përfutuese 2. Zyrtari i Autorizuar / Mbatjesi i Buxhetit 3. Drejtori për Buxhet dhe Financa (DBF) / Zyrtari Kryesor Financiar Komunal (ZKF) 4. Kryetari i Komunës 5. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit 6. Analisti i Buxhetit / Zyrtari Administrativ Komunal 7. Zyrtari Zotues 8. Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) 9. Thesari - Ministria e Financave 10. Menaxheri i Kontratës 11. Zyrtari i Pranimt 12. Komisioni i Pranimt 13. Zyrtari i Shpenzimeve 14. Zyrtari Certifikues 15. [OPTIONAL] Komisioni për Hetimin e Procedurave 16. Zyrtari për Pasuri 17. Zyrtari i Depos 18. Zyrtari i Logjistikës 19. Banka Qendrore e Kosovës (BQK)</p>	<p>Palet e përfshira në proces:</p> <p>1. Sistemet e TI të 2. E-Mail 3. E-Pasuria 4. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) – Platforma e-Prokurimi 5. Programi i Investimeve Publike 6. Sistemi për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Buxhetit (SZHMB)</p>	<p>Dokumentet e përfshira në proces:</p> <p>1. Kërkesa për Mallra dhe Shërbime 2. Memo për Trajtime, Udhëtime, etj. 3. Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve (DNPDF) 4. Dosja e Tenderit 5. Kontratat relevante për furnizim/shërbime / prokurim 6. Kërkesa për blerje 7. Kërkesa e Zotimit për Blerje 8. Kërkesa për Shpenzime 9. Faturat 10. Raportet e Pranimt të Mallit / shërbimeve 11. Urdhër Obligimet për Pagëse 12. Formulari për Identifikim të Furnitorit dhe të Dhënave Bankare 13. Urdhërblerjet nga SIMFK 14. Vendimi për Caktimin e Menaxherit të Kontratës 15. Plan i Menaxhimit të Kontratës 16. Protokollet e Faturave (vulat e pranimt të faturave ose referenca elektronike) 17. Procesverbalet e Komisionit të Pranimt 18. Kërkesa për Lirimin e Fondeve të Pranuar 19. [OPTIONAL] Raporti nga Komisioni Hetues 20. Dokumentet nga programi E-Pasuria</p>
---	--	---

Ndërlidhja:	Numri i hapave:
21. Barkodet nga programi E-Pasuria 22. Raportet e Pagesës Elektronike nga Thesari 23. Raportet e Transfereve të Gabueshme nga BQK 24. Databazat ne Excel	1. Procesi për Shpenzime Komunale 25

2. PROCESI I SHPENZIMEVE - MALLRA DHE SHËRBIME: PROCESI NË DETAJ

Procesi i shpenzimeve publike për Mallra dhe Shërbime						
Hapat	Aktivitetet	Aktivitetet e kontrollit	Përgjegjësi	Afartet	Dokumentet	Korniza ligjore
1.	Nën-procesi: Inicimi i shpenzimeve Plani i rrjedhës së parasë	1.1. Drejtorët e drejtorive së bashku me DBF/ZKF dhe drejtorinë e prokurimit përgatisin planin për rrjedhës së parasë. 1.2. DBF/ZKF e dërgon planin e rrjedhës së parasë në MF.	1. Drejtorët e Drejtorive përkatëse 2. DBF/ZKF 3. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit	Në fillim të vitit	1. Plani i rrjedhës së parasë	1. Rregulloren MF Nr. 03/2014 për Alokimin e Fondave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
2.	Kërkesa për iniciim të shpenzimit	2.1. Për shpenzimet që kërkojnë procedura të prokurimit, zyrtari përgjegjës i njësisë kërkuese (drejtorisë përkatëse) përgatitë: 2.1.1. Për mallra, punë dhe shërbime që janë të planifikuara në planin final të prokurimit, kërkesën me shkrim për mallra, punë dhe shërbime; dhe 2.1.2. Nëse blerja nuk është e planifikuar në planin final të prokurimit, paraqitet arsyetimi për blerje. 2.2. Për shpenzimet që nuk kërkojnë procedura të prokurimit, zyrtari përgjegjës i njësisë kërkuese (drejtorisë) përgatitë: 2.2.1. Kërkesën për shpenzime bazuar në nevojat dhe buxhetin e drejtorisë. 2.3. Inicuesi i kërkesës e dërgon atë tek drejtori	1. Zyrtarët e departamenteve 2. Drejtori i drejtorisë (mbajtësi i buxhetit)	Nuk ka	1. Kërkesa për mallra, punë dhe shërbime në kopje fizike 2. Memo për trajnime, etj. udhëtime, etj.	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Rrregulli financiar Nr. 01/2010/MF – Menaxhimi i Kontrollit Financiar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

						<p>3. Rregull financiarë Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike/Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p>
3.	Vlerësimi i nevojave dhe aprovimi i kërkesës	<p>3.1. Pas pranimit të kërkesës për shpenzime, drejtori i drejtorisë psërkatëse (mbajtësi i buxhetit) kontrollon kërkesën lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> Natyren dhe fushëveprimin e saktë të nevojave që mallrat/shërbimet e kërkuara synojnë të plotësojnë; Vlerën e parashikuar, si dhe kushtet materiale të kontratës publike që do t'i nënshtrohet prokurimit të parashikuar; Specifikat funksionale të secilit mall ose shërbim; Përfitimet e pritura; Nëse prokurimi i synuar ka qenë i përfshirë në planifikimin e prokurimit, nëse jo, arsyet përse shpenzimi nuk është planifikuar; dhe Një deklaratë të qartë se si prokurimi do t'i promovojë objektivat institucionale. 	1. Drejtori i drejtorisë. 2. DBF/ZKF.	Nuk ka	<p>1. Kërkesa për mallra, punë dhe shërbime në kopje fizike. 2. DNPDP. 3. Memo për trajnim, udhëtime, etj.</p>	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2010 - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

	<p>3.2. Drejtori i plotëson pjesën II.1 të Deklaratës të Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondave (DNPDF).</p> <p>3.3. Drejtori dërgon DNPDF e nënshkruar tek DBF/ZKF për kontrollim të disponueshmërisë së fondave.</p>				
<p>4. Kontrolli i disponueshmërisë së fondave</p>	<p>4.1. DBF/ZKF formalisht siguron që fondet janë ndarë për aktivitetin në fjalë dhe janë të mjaftueshme për kryerjen e obligimeve financiare gjatë vitit vijues fiskal.</p> <p>4.2. DBF/ZKF nënshkruan pjesën II.1 të DNPDF-së lidhur me disponueshmërinë e fondave.</p> <div data-bbox="580 548 879 1122" data-label="Image"> </div> <p>4.3. DBF/ZKF e dërgon DNPDF tek Kryetari i Komunës për aprovim dhe nënshkrim.</p>	<p>1. DBF/ZKF</p>	<p>Nuk ka, por para fillimit të shpenzimit</p>	<p>1. DNPDF e nënshkruar</p>	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2010 - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>3. Doracakut i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit - Njësia</p>

						Qendrore Harmonizuese-MF. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)
5.	Aprovimi final i kërkesës për shpenzime dhe për iniciim të shpenzimeve	<p>5.1. Pas pranimit të kërkesës për blerje, kryetari i komunës vlerëson:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nëse vlerësimi i nevojave arsyeton zhvillimin e aktivitetit të prokurimit të kërkuar; dhe Për kërkesa të reja, nëse shpenzimi ndërfillet me objektivat e drejtorisë dhe të komunës. <p>5.2. Nëse kërkesa aprovohet, ajo përcillet tek Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit</p> <p>5.3. Nëse kërkesa nuk aprovohet, ajo kthehet tek drejtori i departamentit (shih aktivitetin 2).</p>	1. Kryetari i komunës	Nuk ka	1. Kërkesa për blerje	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
Nën-procesi: Zotimi i Fondëve						
6.	Përgatitja e kërkesës për zotim dhe regjistrimi i zotimit të fondëve në SIMFK	<p>Për shpenzimet që kërkojnë prokurim:</p> <p>6.1. Pas aprovimit të kërkesës, zyrtari përgjegjës financiar:</p> <ul style="list-style-type: none"> Verifikon nëse mjetet financiare janë në dispozicion në linjën e kërkuar buxhetore; Plotëson të dhënat për Kërkesën e 	1. DBF/ZKF. 2. Zyrtari përgjegjës financiar. 3. Zyrtari zotues.	Tre ditë pas pranimit të dokumentacionit	1. Kërkesa e zotimit për blerje (kopje fizike). 2. Kërkesa për mallra dhe shërbime e krijuar në SIMFK moduli i	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

		<p>Zotimit për Blerje;</p> <ul style="list-style-type: none"> Regjistron kodet e klasifikimit të buxhetit (kodin e fondëve, organizativ, programit, funksionit dhe kodin ekonomik), sasinë; dhe <p>6.2. Zyrtari përgjegjës financiar i përcjell zyrtarit autoritues dhe zotues dokumentin Kërkesën e Zotimit për Blerje.</p> <p>6.3. Zyrtari zotues pas pranimit të dokumentit Kërkesën e Zotimit për Blerje regjistron:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të dhënat në SIMIFK; Kontrollon nëse ka fonde të mjaftueshme në linjën e kërkuar buxhetore dhe fondet e kërkuara ngrihen për obligimet e ardhshme; dhe Përcaktohen datat e mundshme të pagesave; dhe Nënskruan dokumentin Kërkesë për Zotim për Blerje. <p>6.4. Në rastet kur fondet për zotim nuk janë në dispozicion, zyrtari zotues duhet të informojë Drejtorin e Drejtorisë përkatëse përmes ZKF dhe ta kthejë kërkesën.</p> <p>6.5. Nëse fondet zotohen, DNPDF (në kopje fizike) dhe kërkesa për mallra dhe shërbime dërgohet tek zyra e prokurimit.</p>	1. Zyrtari	Brenda tre	1. Kërkesë për	1. Rregullorja e blerjeve dhe të nënskruar nga zyrtari zotues). 2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
7.	Zotimi i fondëve	Për shpenzimet që nuk kërkojnë procedura të	1. Zyrtari	Brenda tre	1. Kërkesë për	1. Rregullorja e

	<p>për shpenzimet operative pa të procedurë prokurimit</p>	<p>prokurimit</p>	<p>zotues.</p>	<p>ditëve pas pranimit të faturës nga DBF/ZKF</p>	<p>shpenzime.</p> <p>1. DNPDP</p> <p>2. Fatura.</p> <p>3. Raporti i pranimit.</p> <p>4. Urdhër obligimi për pagesë (pjesa A) e krijuar në SIMFK - moduli i aprovimit.</p>	<p>Ministritë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
<p>8.</p>	<p>Procesi i prokurimit</p>	<p>8.1. Njësia kërkuese plotëson DNPDP dhe e dërgon tek DBF/ZKF dhe Kryetari i Komunës për aprovim.</p> <p>8.2. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit njoftohet nga AQP paraprakisht për të gjitha kontratat ekzistuese kornizë dhe të njëjtit u dërgohen të gjitha drejtorive dhe programeve në komunë.</p> <p>8.3. Nëse për bërjen e kërkuar ekziston një kontratë kornizë në AQP, njësia kërkuese e përdorë atë kontratë.</p> <p>8.4. Nëse aktiviteti i prokurimit nuk ka qenë i planifikuar, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit e dërgon DNPDP në AQP së paku 5 ditë para autorizimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit.</p> <p>8.5. Nëse AQP nuk synon të zhvillojë procedurë të përbashkëta të prokurimit rreth bërjes në</p>	<p>1. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit</p> <p>2. Njësia kërkuese</p>	<p>5 ditë para inicimit të aktivitetit të prokurimit</p>	<p>1. DNPDP</p>	<p>1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>3. Rregullorja e</p>

		<p>faqë, autoriteti kontraktues vazhdon iniciimin e aktivitetit të prokurimit në faqë.</p> <p>8.6. Zyrtari i prokurimit pas përgatitjes së dosjes së tenderit dorëzon DT tek Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit për aprovim</p> <p>8.7. Pas aprovimit nga ana e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, ZP zhvillon procedurat e prokurimit për prokurimin në faqë.</p>				Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
9.	Procesi i kontraktimit	<p>9.1. Pas dhënies së kontratës dhe para nënshkrimit të kontratës, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, DBF/ZKF dhe Kryetari i Komunës ri-sigurojnë disponueshmërinë e fondëve dhe se informatat financiare janë të njëjta me DNPDF apo në rast se ka ndonjë ndryshim, atëherë konfirmohet nëse mund të sigurohen fondet (duke nënshkruar pjesën e II-të të DNPDF.</p> <p>9.2. Kontratat për shërbime dhe furnizime nën 125,000EUR nënshkruhen prej Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit.</p> <p>9.3. Kontratat mbi 125,000EUR nënshkruhen nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe Kryetari i Komunës.</p> <p>9.4. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dërgon kontratën e nënshkruar tek njësia kërkuese, DBF/ZKF dhe menaxheri kontratës.</p>	<p>1. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit</p> <p>2. Kryetari i Komunës</p>	<p>Kontrata nënshkruhet pas publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës</p>	<p>1. DNPDF</p> <p>2. Kontrata</p>	<p>1. Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
10.	Identifikimi/regjistrimi i furnitorit në	<p>10.1. Pas nënshkrimit të kontratës, ZKF ose</p>	<p>1. DBF/ZKF</p>	<p>Menjëherë pas</p>	<p>1. Formulari për regjistrim të</p>	<p>1. Procedura për regjistrimin</p>

Thesar	<p>zyrtari përgjegjës financiar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Verifikon identitetin e furnitorit; • Plotëson formularin e kërkuar; dhe • Dërgon të dhënat bankare të furnitorit në Thesar. <p>10.2. Nëse furnitori nuk është i regjistruar në SIMFK, ZKF kompletton dokumentet e kërkuara për regjistrimin e furnitorit dhe verifikon saktësinë e informatave të furnitorit (informatat verifikohen në ueb faqet e ATK-së dhe ARBK-së).</p> <p>10.3. ZKF plotëson formularin e regjistrimit të furnitorit dhe e dorëzon në Thesar sipas procedurës për regjistrimin e furnitorëve në SIMFK</p>		nënshkrimi të kontratës dhe para gjenerimit të urdhërblertje s nga SIMFK	furnitorit	e Furnitorëve në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit)
11. Aktivitetet për menaxhimin e kontratës	<p>11.1. Pas nënshkrimit të kontratës, Kryetari i Komunës cakton menaxherin e kontratës (Më detajisht rreth menaxhimit të kontratave, shih procesin e menaxhimit të kontratave)</p> <p>11.2. DBF/ZKF njoftohet për emërimin e menaxherit të kontratës.</p> <p>11.3. Menaxheri i kontratës/projektit në një komunë në bashkëpunim me menaxherin e kontratës së operatorit ekonomik përgatitsin dokumentin plani i Menaxhimit të Kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të</p>	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. Menaxheri i Kontratës/Projektit</p> <p>3. DBF</p>	Pasi të nënshkruhet kontrata	<p>1. Vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës (kopje fizike)</p> <p>2. Plani i menaxhimit të kontratës i nënshkruar nga menaxheri i kontratës dhe operatori ekonomik</p>	<p>1. Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

		Menaxherit të Projektit dhe Operatorit Ekonomik. 11.4. Menaxheri i Projektit/kontratës, brenda 2 ditëve të punës, do ta përcjell një kopje të planit për menaxhimin e kontratës departamentit të prokurimit.				
12.	Krijimi i urdhërbleres	12.1. Pas nënshkrimit të kontratës/regjistrimit të të dhënave bankare të furnitorit në Thesar, menaxheri i kontratës i lëshon operatorit ekonomik letrën e njoftimit respektivisht fletë porosinë (urdhërbleren). 12.2. Menaxheri i kontratës siguron nënshkrimin e furnitorit në urdhërblere për ri konfirmimin e afatave për kryerjen e shërbimeve apo ofrimin e mallrave.	1. Menaxheri i kontratës	Brenda tri ditëve pas nënshkrimit të kontratës	1. Urdhërblerja nga SIM/FK	1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 3. Procedura e Thesarit për rregullat e

						qasjes në SIMFK/(Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
Nën-proces: Verifikimi i shpenzimeve						
13.	Pranimi i faturës	13.1. Fatura pranohet përmes protokollit të zyrës së financave respektivisht nga zyrtari përgjegjës për pranim të faturave.	1. Zyrtari përgjegjës për pranim të faturave	Nuk ka	1. Protokollimi i faturës.	Nuk ka
14.	Pranimi fizik i mallrave dhe shërbimeve	14.1. Menaxheri i kontratës monitoron implementimin e kontratës dhe pranimin final të mallrave dhe shërbimeve. 14.2. Pranimi i mallrave/shërbimeve bëhet nga: <ul style="list-style-type: none"> Zyrtari i pranimit të mallit për blerjet nën 1,000 EUR; dhe Komisioni i pranimit për blerjet mbi 1,000 EUR (komisioni caktohet nga kryetari bazuar në propozimin e drejtorit të drejtorisë përkatëse). 14.3. Komisioni i pranimit të mallrave/shërbimeve kontrollon: <ul style="list-style-type: none"> nëse sasia, cilësia dhe karakteristikat e mallit/shërbimeve të pranuar janë në përputhje me kontratën (specifikat teknike); krahason nëse fletëdërgesa e mallit përputhet me urdhërblerjen; dhe 	1. Zyrtari i Pranimit për Blerjet nën 1,000 EUR 2. Komisioni për pranim fizik të mallrave	Nuk ka	1. Procesverbali i komisionit (në letër) 2. Raporti i pranimit	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 - Menaxhimi i Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

				<p>3. Procedura e Thesarit për rregullat e dasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>4. Procedura e Ministrisë së Financave Nr. 5 – Menaxhimi i Pasurive (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).</p> <p>5. Procedura e Ministrisë së Financave Nr.</p>
<ul style="list-style-type: none"> nëse mallrat/shërbimet nuk përcupthen me kontratën dhe urdhërblejren, komisioni për pranim të mallrave i kthen ato tek operatori ekonomik apo jep vërejtjet e tij për korigjim <p>14.4. Komisioni i pranimit pas pranimit të mallrave/shërbimeve përpilon një raport të pranimit që nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.</p> <p>14.5. Raporti i pranimit të mallrave/shërbimeve nga komisioni i pranimit dërgohet tek zyra për buxhet dhe financa (së bashku me kontratën, urdhër blerjen, faturën etj.)</p>			<p>4. Procedura e Ministrisë së Financave – Procedurat e Thesarit).</p>	

						11 - Kapitali (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
15.	Regjistrimi i pranimi të mallrave/shërbimëve në SIMFK	15.1. Zyrtari përgjegjës për pranimin e mallrave në SIMFK regjistron pranimin e mallrave në SIMFK. 15.2. Zyrtari për pranimin e mallrave dërgon raportin e pranimi të mallit nga SIMFK dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës të zyrtari i shpenzimeve.	1. Zyrtari për pranim të mallit në SIMFK	Nuk ka	1. Raporti i pranimi të mallit nga SIMFK	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).. 3. Procedura e Thesarit për rregullat e dasjes në SIMFK (Ministria e Financave – Procedurat e Thesarit).
16.	Çertifikimi (kontrollimi) i dokumentacionit për pagesë nga Zyrtari Çertifikues	16.1. Para se të regjistrohet shpenzimi në SIMFK, Zyrtari çertifikues çertifikon dokumentacionin për pagesë 14 si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesën për shpenzime; • DNPDF; • Zotimin e fondeve në SIMFK; 	1. Zyrtari çertifikues	Pas regjistrimit të pranimi të punëve në SIMFK	Nuk ka	1. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 - Shpenzimi i Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

		<ul style="list-style-type: none"> • Urdhërblerja në SIMFK; dhe • Procesverbalin dhe raportin e pranimi të komisionit të pranimi teknik. 				
17.	Regjistrimi i shpenzimit në SIMFK	<p>17.1. Zyrtari shpenzues pas pranimi të dokumentacionit verifikon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zotimin e fondeve në SIMFK; • Nënshkrimet e autorizuaraj; • Kodet ekonomike të shpenzimit; dhe • Përfituesin dhe llogarinë bankare. <p>17.2. Zyrtari shpenzues bën regjistrimin e shpenzimit në SIMFK dhe gjeneron Urdhrin për Paguesë.</p> <p>17.3. Zyrtari i shpenzimeve përcjell dokumentacionin e plotë financiar të zyrtari certifikues për aprovim të shpenzimeve në SIMFK.</p>	1. Zyrtari i shpenzimeve	Brenda tri ditëve nga pranimi i dokumenteve e në zyre	1. Dokumenti Urdhëri për Paguesë nga SIMFK	NA
Nën-procesi: Lirimi i fondeve të pa përdorura						

18.	Lirimi i fondëve të përdorura	<p>18.1. Zyrtari shpenzues kontrollon vlerën totale të faturave kundrejt fondëve të zotuarra dhe përgatitë një kërkesë për Thesarin në MF për lirim të fondëve të lira nga zotimi përkatës.</p> <p>18.2. Kërkesa për lirin e fondëve duhet paraprakisht të aprovohet nga personat përgjegjës në komunë.</p> <p>18.3. Kërkesa e aprovuar dërgohet në Thesar.</p>	1. Zyrtari i shpenzimeve. 2. DBF / ZKF 3. Kryetari i Komunës	Nuk ka	1. Kërkesa për lirin e fondëve të përdorura (kopje fizike).	1. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-148 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
